



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:172745

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05856161

Numri i lëndës: 2020:172745

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05855906

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, në lëndën kontestimore të Paditësës së mitur E. P. , nga fshati ..., të cilën me autorizim e përfaqëson, përfaqësuesi Ligjor I. P. , e të cilit i përfaqëson V. R., avokat nga Prishtina , Rruga "...”nr.8/5, kati i dytë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimit “ ... ” , me seli në Prishtinë, rruga “...” nr. 69 , për çështjen kontestuese kompensim dëmi, në seancës e datës 24.06.2024, në mungesën e palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datën 25.05.202, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T V E N D I M

I. Padia e paditësës së mitur E. P. , nga fshati ..., e ushtruar më datën 17.11.2020, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “... ” , me seli në Prishtinë, për çështjen kontestuese kompensim dëmi , konsiderohet **E TËRHEQUR**.

II. Gjykata konstaton se pala paditëse e ka paguar taksen gjyqësore për padi ne shume prej 30€ , me rastin e dorëzimit te padisë ne gjykate.

A r s y e t i m

Paditësja përmes te autorizuarit, më datën 17.11.2020, në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, ka ushtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “ ...” , me seli në Prishtinë, për çështjen kontestuese kompensim dëmi. Me këtë padi ka kërkuar qe të

detyrohet e paditura që t'ia paguaj shumat e cekura në kërkesëpadi, të gjitha me kamate prej 8%, duke filluar që nga data e ushtrimit të padisë, gjere në pagesën përfundimtare. Po ashtu, i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha në afatin prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata për datën 24.06.2024, e ka caktuar seancën përgatitore, i ka ftuar palët, të cilat edhe pse e ftuar me rregull nuk kanë prezantuar në seancën, mungesën nuk e kanë arsyetuar dhe nuk kanë kërkuar shtyrjen e seancës.

Gjykata padinë e paditësit e konsideroj të tërhequr, sepse pala paditëse, është ftuar në mënyrën e paraparë ligjore, e njëjta nuk ka prezantuar në seancën përgatitore, mungesën nuk e ka arsyetuar, nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës. Prandaj gjykata veprimi konform nenit 409.1, të LPK-së, me të cilën dispozitë është e paraparë në qoftë se në seancën përgatitore, nuk vjen pala paditëse edhe pse është ftuar rregullisht konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Me dispozitën e cekur më lartë, është paraparë pasoja e mungesës së palës në seancën kryesore. Kështu mungesa e paditësit në seancën kryesore e tërheq në vete presumcionin e tërheqjes së padisë. Prandaj për tu konsideruar si e tërhequr padia duhet të plotësohen kushtet edhe atë: mungesa e paditësit në seancë, ftesa të jetë bërë me rregull dhe mungesa të mos jetë arsyetuar. Se pala paditëse është ftuar me rregull, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga procesverbali i datës 07.06.2024, nga e cila ftesë vërtetohet se pala paditëse është ftuar me rregull dhe mungesën nuk ka arsyetuar dhe nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës kryesore.

Përcaktimi i ligjdhënësit, për një zgjedhje të tillë, duhet kërkuar në faktin se procedura kontestimore inicohet, me vullnetin ekskluziv të palës paditëse, prandaj vazhdimi i procedurës pa pjesëmarrjen e paditësit në procedurë nuk do të kishte kurrfarë kuptimi.

Përveç kësaj është në interesin e paditësit që procedura të përfundojë në afat sa më të shkurtër, prandaj sjellja pasive e paditësit në raport me kontestin është tregues, se paditësi e ka humbur interesin për vazhdimin e më tej të kontestit.

Prandaj gjykata duke marrë parasysh të cekurat më lartë ka zbatuar dispozitën e nenit 409.2, të LPK-së, duke e konsideruar të tërhequr padinë e paditëses, sepse paditësi ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk kanë kërkuar shtyrjen e seancës kryesore.

Gjykata sa i përket shpenzimeve vendosi qe secila palë ti përballon shpenzimet e krijuara , sepse palët nuk i kanë kërkuar shpenzimet, ndërsa pala paditëse e ka paguar taksën gjyqësore.

Nga se u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,

Dega në Kaçanik

C.nr.492/2020 prej datës 24.06.2024

Gjyqtari

Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur, mund të ushtroj ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.

Dërguar me datën 25.06.2024

Paditësit 1x1

Të paditurit 1x1